**VENDIM**
**Nr. 199, datë 4.3.2015**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË, TE BASHKIA KORÇË, TË OBJEKTIT BAZA PRODHUESE E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", PËR PËRDORIM NGA SHKOLLA E MESME BUJQËSORE "IRAKLI TEROVA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "d", të nenit 23, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar dhe neneve 3/b e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga universiteti "Fan S. Noli", Korçë, te bashkia Korçë, të objektit baza prodhuese e universitetit "Fan S. Noli", Korçë, së bashku me truallin nën objekt, për përdorim nga shkolla e mesme bujqësore "Irakli Terova", sipas planimetrisë dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 235, datë 27.3.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga bashkia Korçë tek universiteti "Fan S. Noli", Korçë, të objektit baza prodhuese e shkollës së mesme bujqësore "Irakli Terova", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, universiteti "Fan S. Noli", Korçë, bashkia Korçë dhe shkolla e mesme bujqësore "Irakli Terova" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

Bashkia Korçë

Fusha e perdorimit te Prones: Arsim

Identifikoi: Ervin KAJNO,
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Zhani PEPO
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Gjergji DURO, Kryetari i Bashkise
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend | Zona Kadastr.& Indeksi i Hartes | Nr Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m²) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m²) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te vecanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 547 | 8564 Ko-L-7 | 4\12 | Truall + Ndertese | Shkolla e Mesme Agrobiznes Rr."Ajet Gjindoli" | 1288 | 387 | Arsim Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimit Shkolle Pilot | Ndertese me 3 kate + oborr para Kend sportiv i perb. |
| 548 | 8564 Ko-L-7 | 4\13 | Ndertese | Baza Prodhuese "Irakli Terova" Rr. e Voskopojes | 33000 m2 | | Ambjente ndihmese | | | Ka ndryshime ne sip. e prones |
| 549 | 8561 Ko-L-10 | 1\60 | Truall + Ndertese | Shkolla "Malteze" Blloku i ri i Sporte | 2685 | 371 | Arsim Parauniversitar | | | |

# PLAN VENDOSJE

SHKALLA 1:2500

PALA PADITËSE : Athina Xhumetiku

I PADITUR : Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë




TOKË ARË E MBIVENDOSUR ME SIP. 21850 M2 ARË
ME KUFIZIME :
VERI : Rrugë dhe truall me sip.2099.2 i paditëses
LINDJE: Kanal
JUGË : Tokë arë e bazës prodhuese
PERËNDIM : Kanal
TOKË ARË E MBIVENDOSUR ME SIP. 1700 M2 ARË

TOKË ARË E MBIVENDOSUR
ME SIPË RFAQE 1700 M2 ARË
ME KUFIZIME :
VERI : Rrugë
LINDJE : Rrugë
JUGË : Tokë arë e bazës prodhuese
PERËNDIM : Kanal

ZËNË ME TOKË TË NDARË NË PRONËSI 250 M2

ZËNË NGA KANAL 300 M2

ZËNË NGA KANAL 900 M2

Korcë ,më 23.07.2010


HARTË ME INDEKS K -34 -126
Korçë
P
L
J
VIJA KUFIZUESE E BAZËS PRODHUESE TË
SHKOLLËS SË MESME BUJQËSORE " IRAK
TËROVA " ME SIPËRFAQE 33.25 Ha ARË
VIJA E VERDHË E QYTETIT KORÇË
a
102
7.64 Ha
206
205
101
1.06 Ha
212
T.R.
100/2
2.18 Ha
a
100/1
0.30 ha
a
99
2.15 ha
a
102/2
1.85 ha
PUNOI
EKSPERTI
Top. Robert PAPI
Nr. Lic. TZ 0423
Drenicës